

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 492/1 dt. 03.06.2013
PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIT PËR SJELLJEN E PROGRAMIT
PËR PLOTËSIM TË PROGRAMIT VJETOR PËR PËRPUNIMIN E
PLANEVE URBANISTIKE NË TERRITORIN E
KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2013

25.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),
Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

SHPALLET përfundimi për sjelljen e Programit për plotësim të Programit vjetor për përpunimin e Planeve urbanistike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2013, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e tretë dt.29.05.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

P Ë R F U N D I M

Nr. 07-453/3 dt. 29.05.2013

**PËR SJELLJEN E PROGRAMIT PËR PLOTËSIM TË PROGRAMIT
VJETOR PËR PËRPUNIMIN E PLANEVE URBANISTIKE NË
TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2013**

26.Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale („Gazeta zyrtare e RM,, nr.5/02) si dhe nenit 59 të Statutit të komunës („Kumtesa zyrtare e Komunës,, nr 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 3^{te} datë 29.05.2013 përfundoi:

1.Këshilli i Komunës Dibër sjell Programin për plotësim të Programit vjetor për përpunimin e planeve urbanistike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2013.

2.Plotësim Programi nga neni 1 është pjesë përbërëse e Përfundimit.

3.Ky përfundim hyn në fuqi një ditë pas shpalljen në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

KËSHILLI I KOM UNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

Nr.3/03.06.2013 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 29

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1 i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e R.M." 51/05, 137/07, 91/09, 124/10, 18/11, 53/11 dhe 144/12) si dhe nenit 27 të Statutit të Komunës së Dibrës (Kumtesa zyrtare e Komunës" nr. 14/03),

Këshilli i Komunës Dibrë në seancën e 3^{te} dt. 29.05 .2013 sjell :

PROGRAM PËR PLOTËSIMIN E PROGRAMIT VJETOR PËR PËRPUNIMIN E PLANEVE URBANISTIKE NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2013

1.Me Këtë Program bëhet plotësimi i Programit vjetor për përpunimin e planeve urbanistike në territorin e Komunës Dibrë për vitin 2013 (shpallur në Kumtesën zyrtare të Komunës" nr. 38/12)

2.Në Tabelën që ka të bëjë me RAJONET KU DO TË REALIZOHET PLANIFIKIMI URBANISTIK gjatë vitin 2013, pas pikës 9 shtohen edhe 5 pikat 10,11,12,13 dhe 14 si vijon:

	PU -kufizimi	sipëfaqja	shuma
10	Plotësim dhe ndryshim i Planit Gjeneral Urbanistik për qytetin e Dibrës për blokun 3, 4 dhe 20	42.7 ha	700.000,00
11	PDU për pjesë të blokut 4 – Dibrë, me këta kufinj: Perëndim: bulevari 200; Veri-bulevari 100;jug- rr. Urfi Agolli dhe lindje rr. 8-të Shtatori	7.8 ha	400.000,00
12	PDU për pjesë te blokut 12 – Dibrë, me këta kufinj: Veri - rr. Urfi Agolli; Lidje- rr Mosha Pijade; Perëdnim- rruga e Proletarijatit dhe jug pacelat kadastrale 5370 dhe 5588/1 KK Dibrë-1	3.2 ha	300.000,00
13	Plan Detal Urbanistik Bloku 20 Dibrë	13.7 ha	500.000,00
14	PDU pjesë e Bllokut 3 me këta kufinj: veri rr."Atanas Iliç,perëndim rr."Beton",jug rruga e re e paraparë, verilindje rr."Velko Vllahoviç"	4 ha	400.000,00
	Gjithsejt:		2.300.000,00

3.BURIMET FINANCIARE

-vlera e Buxhetit të Komunës shtohet për 1.100.000,00 denarë
dhe prej 1.850.000 den bëhet..... 2.950.000,00 denarë
-vlera e personave juridik dhe fizik shtohet për 1.200.000,00
denarë dhe prej 3.750.000 bëhet..... 4.950.000,00 denarë
-Vlera e përgjithshme shtohet për 2.300.000 denarë dhe
prej 5.600.000,00 denarë bëhet..... 7.900.000,00 denarë

4. Ky program hyn në fuqi një ditë pas shpalljen në Kumtesën zyrtare të Komunës.

**Nr.07-453/4
29.05.2013
D i b ë r**

**KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari
Bashkim Mashkulli d.v.**

K O N K L U Z I O N

Nr.08- 492/2 dt. 03.06.2013

**PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR SJELLJEN E PLANIT DETAL
URBANISTIK PËR PJESËN QENDORE TË QYTETIT PJESË E
BLOKUT 1 DHE 2 -DIBËR**

27.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

SHPALLET vendimi për sjelljen e Planit Detal Urbanistik për pjesën qendrore të qytetit, pjesë e bllokut 1 dhe 2 Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e tretë dt.29.05.2013.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr.07-453/5 dt 29.05.2013

PËR SJELLJEN E PLANIT DETAL URBANISTIK PËR PJESËN QENDORE TË QYTETIT PJESË E BLOKUT 1 DHE 2 -DIBËR

28.Në mbështetje të nenit 26, paragrafi 5 alinea 1 të Ligjit për planifikim hapsinor dhe urbanistik (“Gazeta zyrtare RM-së” nr. 51/05, 137/07, 91/09, 124/10, 18/11 53/11 dhe 144/12), nenit 22, paragrafi 1, pika 1 dhe nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 5/02) dhe nenit 27 paragrafi 1 pika 7 të Statutit të komunës Dibër, (“Kumtesa zyrtare e komunës Dibër” nr. 14/03),

Këshilli i komunës Dibër në seancën e 3^{të} datë 29.05.2013 vendosi:

Neni 1

Sjelllet PLANI DETAL URBANISTIK PËR PJESËN QENDORE TË QYTETIT PJESË E BLOKUT 1 DHE 2 -DIBËR me sipërfaqe prej 14.5 ha me këta kufinj: verilindje rr. “APJ “ dhe “Velko Valhoviç”, në veri “Ibe Palikuqa” dhe “Jordan Zafirovski”, në veriperëndim “Amdi Lleshi dhe në Jug- rr. “Atanas Iliç”.

Neni 2

Plani nga neni 1 i këtij Vendimi është i përpiluar nga **ZUAS- Shkup me nr. teknik 2438/2 maj 2013** i cili përmban pjesën tekstuale dhe grafike.

Neni 3

Plani verifikohet në afat prej 8(tetë) ditësh nga dita e miratimit në 7 (shtatë) ekzemplarë dhe ju dërgohen shërbimeve përkatëse.

Neni 4

Planin do ta zbatojë organi kompetent i komunës Dibër

Neni 5

Ky Vendim me një ekzemplar të verifikuar të Planit i dorëzohet Organit të administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e regullimit të hapsirës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Kumtesën zyrtare të komunës Dibër”

KËSHILLI I KOMUNËS

Kryetari,

Bashkim Mashkulli

K O N K L U Z I O N

Nr.08- 492/3 dt. 03.06.2013

**PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR TRANSPORT TË
UDHËTARËVE NË LINJË KOMUNALE
NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR**

29.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

SHPALLET vendimi për transport të udhëtarëve në linjë komunale në territorin e Komunës Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e tretë dt.29.05.2013.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr.07-453/6 dt.29.05.2013

**PËR TRANSPORT TË UDHËTARËVE NË
LINJË KOMUNALE NË TERRITORIN E KOMUNËS DIBËR**

30.Në mbështetje të nenit 22 të Ligjit për transport në komunikacionin rrugor dhe Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për transport në komunikacionin rrugor („Gazeta zyrtare e RM”, nr. 68/04, 127/06, 83/10, 17/11, 53/11, dhe 6/12), nenit 27, paragrafi 1, pika 20 të Statutit të Komunës Dibër (Kumtesa zyrtare e Komunës Dibër, nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër, në seancën e 3^{të} datë 29.05.2013 vendosi:

I.Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Vendim rregullohet transporti i udhëtarëve në linja komunale, në territorin e Komunës Dibër me çka veçanërisht përcaktohen:

1. Rrjeti unik i linjave,
2. Orari unik i udhëtimit, mënyra e vendosjes së saj, mbajtja dhe ndryshimi,
3. Mënyra e organizimit të kontrollit për qarkullimin e komunikacionit të automjeteve dhe linjave, si dhe evidencën për të,
4. Sistemin tarifor dhe sistemin e arkëtimit,
5. Lokacionin e terminalit të autobusëve, vendqarkimin, ndalesat dhe procedurat për ndryshimin e tyre,
6. Ndërtimin, shënimin, paisjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e ndalesave,
7. Përcaktimin e relacioneve dhe vendeve për transport me furgonë me më së paku nëntë karige (8+1), dhe
8. Kriteret për mënyrën dhe procedurën për lëshimin dhe heqjen e lejes për kryerje të transportit në linjat komunale dhe ndarjen e linjave transportuesve në transportin e udhëtarëve në linjë komunale.

Transporti i udhëtarëve në linjë komunale është transport publik që bëhet në territorin e Komunës Dibër.

Transport të udhëtarëve në linjë komunale mund të bëjnë transportuesit që do të fitojnë licencë për kryerjen e transportit të atij lloji për territorin e Komunës Dibër.

Licencë për kryerjen e transportit të udhëtarëve në linjë komunale për territorin e Komunës Dibër mund të fitojë personi juridik dhe fizik vendas (në tekstin në vijim-transportuesi) nëse i plotëson kushtet në vijim:

-të jetë i evidentuar në Regjistrin qendror të RM dhe të ketë të regjistruar veprimtari parësore/shifër kryesore të ardhurash për kryerje të transportit të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacion rrugor;

-të jetë pronar i një ose më shumë automjeteve të regjistruara për transport ose të ketë kontratë lizing, të cilat i përmbushin kushtet e veçanta teknike-eksplotuese të përcaktuara për automjetet për kryerjen e llojeve të caktuara të transportit të brendshëm rrugor në linja komunale (dy ose më tepër automjete të regjistruara ose të ketë marrëveshje për lizing për automjete më së paku me 16+1 ulëse;

-të ketë të punësuar shoferë në marrëdhënie të regullt pune, vartësisht nga numri i automjeteve, minimum një shofer për një automjet që i përmbushin kushtet e përcaktuara me rregullat e sigurisë në komunikacionin rrugor;

-drejtuesi ose personi i autorizuar, përgjegjës për transport, të posedojë certifikatë për kopetencë profesionale;

-të mos jetë në fuqi aktgjykimi i plotfuqishëm gjiqësor për vepër penale kundër pronës, ekonomisë ose sigurisë në komunikacionin rrugor;

-të ketë në pronësi të tij kapacitet për parkim dhe mirëmbajtje të automjeteve me të cilat do ta kryejë transportin, si dhe vende ku do t'i mbajë automjetet gjatë kohës kur ato nuk përdoren ose marrëveshje të vërtetuar nga Noteri për të drejtë të siguruar për shfrytëzimin e kapacitetit të këtyllë për një periudhë kohore së paku katër vjet.

II.Rrjeti unik i linjave**Neni 2**

Për territorin e Komunës Dibër, për transport të udhëtarëve në linjë komunale përcaktohet rrjeti unik i linjave, edhe atë:

Nr.	Emri i linjës	Trasa e linjës
1	Dibër - f.Banisht	Dibër - f. Krivcë - f. Hame - f.Banisht
2	f.Banisht - Dibër	f.Banisht - f. Hame - f. Krivcë - Dibër
3	Dibër - f.Zepisht	Dibër - f. Otishan - f. Zepisht
4	f.Zepisht - Dibër	f.Zepisht - f. Otishan - Dibër
5	Dibër - f.Mogorçë	Dibër - ura e Boshkut - f.Mogorçë
6	f.Mogorçë - Dibër	f.Mogorçë - ura e Boshkut - Dibër
7	Dibër - f.Kosovrast i Poshtëm.	Dibër - f.Kosovrast i Poshtëm
8	f.Kosovrast i Poshtëm. - Dibër	f.Kosovrast i Poshtëm - Dibër
9	Dibër - f.Kosovrast i Epërm.	Dibër - f.Kosovrast i Poshtëm. - f.Kosovrast i Epërm.
10	f.Kosovrast i Epërm.- Dibër	f.Kosovrast i Epërm.- f.Kosovrast i Poshtëm. - Dibër

Neni 3

Linja, është relacioni i caktuar dhe drejtimi i vozitjes nga stacioni fillestar deri te stacioni i fundit i autobusit ose stacion në të cilin transportohen udhëtarë në transportin rrugor në linjë, në pajtim me orarin e udhëtimit që më parë të përcaktuar, të regjistruar dhe shpallur, si dhe çimi i transportit.

Linja në transportin eudhëtarëve në linjë komunale ka numrin dhe emrin e vet..

Numri dhe emri i linjës vendoset në vend të dukshëm në automjet, në ndalesat e autobusëve dhe në vendqarkimin e autobusëve.

III. Rrjeti unik i vozitjes, mënyra e vendosjes, mbajtja dhe ndërrimi**Neni 4**

Orari i udhëtimit, është dokument me të cilin përcaktohet linja, lloji i transportit, relacionet në të cilat bëhet transporti, radha e stacioneve dhe ndalesave, largësia midis tyre, nga stacioni fillestar ose ndalesa, koha e arritjes, ndalimi dhe shkuarja në çdo stacion autobusi dhe ndalesë, periudha gjatë së cilës transportuesi e bën transportin e linjës dhe koha e vlefshmërisë.

Neni 5

Procedura për verifikimin e orareve të reja të udhëtimit dhe për ndrimin të orareve të udhëtimit të aprovuar për linjat e përcaktuara dhe për dhënie të lejes për kryerje të transportit të udhëtarëve në linjat e përcaktuara, përmbledh veprime me të cilat transportuesi që disponon licencë për kryerje të transportit të udhëtarëve në linjat komunale në territorin e Komunës Dibër fiton të drejtën të bëjë transport të udhëtarëve në linjat e përcaktuara.

Neni 6

Lejimi i orareve të udhëtimit për linja të reja, si dhe ndërrimin e orareve të udhëtimit për linjat e aprovuara në transport të udhëtarëve në linjat komunale bëhet një herë në vit.

Neni 7

Spektori për urbanizëm, punë komunale, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe ZhEL i komunës Dibër, në fillim të çdo viti dhe më së voni deri me 1 Mars shpall njoftim për aprovim të orareve të udhëtimit për orare të reja dhe për ndërrim të orareve të udhëtimit për linja të aprovuara.

Njoftimi shpallet në UEB faqen e Komunës Dibër dhe në minimum dy vende publike.

Nr.3/03.06.2013 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 35

Në shpallje përcaktohet afati për dorëzim të kërkesave dhe kushteve në pajtim me nenin 24 të Ligjit për transportin e udhëtarëve në komunikacionin rrugor që duhet t'i plotsojë transportuesi që të mund të jetë pjesëmarrës në te.

Në shpalljen nga paragrafi 1 i këtij neni, kërkesën për ndërrimin e orarit të udhëtimit për linjën e përcaktuar për të cilën është dhënë leja, mund të iniciojë transportuesi përsa vlefshmëria e lejes dhe orari i udhëtimit skadojnë mbrenda vitit.

Neni 8

Kërkesa për aprovim të orarit të udhëtimit dorëzohet në Sektorin për urbanizëm, punë komunale, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe ZhEL i Komunës Dibër, në afatin e përcaktuar në shpallje, në zarfë të mbyllur, me postë të rekomanduar ose me dorëzim në arkivin e Komunës Dibër, me praninë të verifikuar.

Neni 9

Kërkesa për aprovim të orarit të udhëtimit dhe për ndërrim të orarit të udhëtimit të aprovuar i përmban shënimet në vijim:

- Emërtimin e plotë, selinë dhe adresën e transportuesit,
- Numrin amzë dhe numrin tatimor të transportuesit,
- Llojin e transportit për të cilin kërkohet verifikimi i orarit të udhëtimit, respektivisht ndërrimi i orarit të udhëtimit për të cilin është dhënë leja.

Kërkesën duhet ta nënshkruajë dhe vërtetojë nga përfaqësuesi ligjor i transportuesit.

Neni 10

Me kërkesën, transportuesi dorëzon dëshmi për plotësimin e kushteve për miratim të orarit të udhëtimit, edhe atë:

- kopje të licencës për kryerje të transportit të udhëtarëve në linjë komunale për territorin e Komunës Dibër,
- kopje të të gjithë orareve të udhëtimit që i janë aprovuar,
- numër të automjeteve (të veta ose kontratë lizing), me të cilët disponon, të cilët i përmbushin kushtet e veçanta teknike-eksplotuese për kryerjen e transportit në linja komunale,
- propozim të orarit të udhëtimit për linjën, të përgaditur në formular të përcaktuar, dhe
- numër të shoferëve në marrëdhënie të rregullt pune varësisht nga numri i automjeteve (minimum një shofer për një automjet), që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me rregullat e sigurisë në komunikacionin rrugor.

Si dëshmi për plotësimin e kushteve nga paragrafi 1, alineja 3 e këtij neni, transportuesi dorëzon listë të automjeteve të regjistruara në emër të firmës në pajtim me rregjistrimin në Rregjistrin qendror dhe fotokopje të librezës së automjetit për çdo automjet në veçanti, respektivisht fotokopje të Kontratës për lizing dhe të librezës së automjetit të vërtetuara në Noter për automjetet që i shfrytëzon më kontratë për lizing nga distributor i autorizuar dhe vërtetim për plotësimin e kushteve të veçanta teknike-eksplotuese të parapara për automjetet për kryerjen e transportit në linja komunale.

Nëse orari i udhëtimit për linjën është me shumë nisje të cilat nuk mund të mbahen me një automjet transportuesi duhet për ato orare udhëtimit të ketë po aq automjete sa është e nevojshme që të mundet t'i mbajë gjithë nisjet.

Si dëshmi për plotësimin e kushtit nga paragrafi 1, alineja 5 e këtij neni, transportuesi dorëzon listë të shoferëve të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune, me fotokopje të formularit M1/M2 dhe vërtetim nga Fondi për sigurim pensionist invalidor, për kompensime të paguara jo më të vjetër se tre muaj për çdo shofer në veçanti.

Neni 11

Kërkesa për aprovim të orarit të udhëtimit për linja të reja respektivisht për ndërrim të orarit të udhëtimit për linja të aprovuara i shqyrton Komisioni i formuar nga kryetari i Komunës Dibër.

Kërkesat e dorëzuara pas kalimit të afatit të përcaktuar në shpallje, si dhe kërkesat me të cilat nuk janë bashkëngjitur dëshmitë e parapara me ligj nuk merren në shqyrtim dhe Komisioni do t'i trajtojë si jokomplete.

Nr.3/03.06.2013 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 36

Për kërkesat e kompletuara në afatin e paraparë në shpallje, Komisioni i paragrafit 1 të këtij neni, në pajtim me kriteret e përcaktuara me këtë Vendim, përgatit propozim listën e kërkesave të aprovuara ose refuzuara të cilat i dorëzon te kryetari i Komunës Dibër për miratim.

Neni 12

Në bazë të listave të aprovuara përgatiten aktvendime.

Ekzemplari i aktvendimit me të cilin aprovohet orari i udhëtimit, respektivisht refuzohet dorëzohet te transportuesi.

Neni 13

Transportuesi, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, deri te kryetari i Komunës Dibër dorëzon kërkesë për regjistrim të orarit të udhëtimit të lejuar dhe për dhënie të lejes për linjën për të cilën është lejuar orari i udhëtimit.

Me kërkesën për regjistrim të orarit të udhëtimit dhe dhënie të lejes për transportin në linjën komunale dorëzohet dokumentacioni në vijim:

- aktvendim të orarit të udhëtimit të lejuar,
- 10 egzemplarë të orarit të udhëtimit të aprovuar i përgatitur në formularin e përcaktuar,
- dëshmi për pagesë të taksës administrative për regjistrim të orarit të udhëtimit,
- dëshmi për pagesë të taksës administrative për dhënie të lejes (në varësi nga numri i lejeve).

Nëse transportuesi kërkesën për regjistrim të orarit të udhëtimit të aprovuar dhe për dhënien e lejes nuk e dorëzon në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni, do të llogaritet se i njëjti nuk është i interesuar për mbajtje të linjës dhe e njëjta do të shlyhet nga regjistri i linjave të aprovuara.

Neni 14

Orari i udhëtimit regjistrohet në emër të transportuesit.

Nëse transportin duan ta kryejnë bashkërisht më shumë transportues, orari i udhëtimit regjistrohet në emër të të gjithë transportuesve.

Neni 15

Gjatë përcaktimit të orarit të udhëtimit për linjë të përcaktuar në transportin e udhëtarëve në linja komunale, transportuesi duhet të ketë kujdes për intervalin kohor të nisjes së orareve që janë aprovuar, i cili është minimum 20 minuta.

Nisja është koha që shënon fillimin të kryerjes së transportit në fillim dhe në të gjitha stacionet e evidentuara në orarin e udhëtimit.

Neni 16

Vendi për ndalesë në orarin e udhëtimit për transport të udhëtarëve në linjë komunale janë ndalesat e përcaktuara për autobusë në pajtim me këte vendim.

Neni 17

Kërkesa për aprovim të orarit të udhëtimit për linja të reja ose për ndërrim të orarit të udhëtimit nuk do të aprovohet nëse në procedurë për aprovim të saj konstatohet që transportuesi gjatë përcaktimit të orarit të nisjes, nga stacioni fillestar dhe stacionet për rrugë, nuk i ka respektuar kriteret e përcaktuara në nenin 15 të këtij vendimi ose intervalet kohore të propozuara në orarin e udhëtimit në dy ose më shumë stacione përputhen me oraret e udhëtimit që janë aprovuar.

Neni 18

Nëse në procedurë për aprovim, regjistrim i orarit të ri të udhëtimit, ka kërkesa nga dy ose më shumë transportues me stacion fillestar dhe përfundimtar të njëjtë, prioritet ka transportuesi me seli në stacionin fillestar.

Neni 19

Vlefshmëria e orarit të udhëtimit për kryerje të transportit të udhëtarëve në linja komunale vazhdohet me kërkesë të transportuesit.

Kërkesa për vazhdim të orarit të udhëtimit dorëzohet deri te kryetari i Komunës Dibër, më së voni 30 ditë para skadimit të afatit.

Me kërkesën për vazhdim të orarit të udhëtimit për kryerje të transportit të udhëtarëve në linja komunale, transportuesi është i detyruar t'i dorëzojë dokumentet në vijim:

-kopje të licencës për transport të udhëtarëve në linja komunale për territorin e Komunës Dibër,

-listë të automjeteve në pronësi ose automjete që i shfrytëzon me kontratë lizing, me fotokopje të librezave të komunikacionit të vërtetuara në noter,

-listë të shoferëve në marrëdhënie të rregullt pune, dhe vërtetim për pagesën e kontributeve në bazë të punësimit,

-numër të nevojshëm të orarit të itinerarit dhe çmimore, dhe

-dëshmi për taksën administrative të paguar.

Neni 20

Kryetari i Komunës Dibër nuk do ta vazhdojë vlefshmërinë e orarit të udhëtimit dhe lejen për kryerjen e transportit të udhëtarëve në linja komunale nëse transportuesi:

-nuk dorëzon kërkesë për vazhdim të vlefshmërisë të orarit të udhëtimit dhe lejen në afatin nga neni 19 të këtij vendimi,

-nuk ka licencë të vlefshme,

-nuk ka numër të mjaftueshëm kapacitetesh dhe së paku një shofer për automjet në marrëdhënie të rregullt pune.

Neni 21

Orari i udhëtimit për transportin e udhëtarëve në linja komunale mund të ndërpresë vlefshmërinë edhe para skadimit të afatit për të cilin është regjistruar, nëse:

-transportuesi nuk i plotëson më kushtet në bazë të së cilave i është lëshuar,

-ndërpritet vlefshmëria e licencës,

-me kërkesë të transportuesit, dhe

-transportuesi e ndalon egzistimin në bazë të rregullave të tjera të veçanta.

Neni 22

Orari i humbur i udhëtimit, i dëmtuar ose i vjetëruar, me kërkesë të transportuesit mund të ndërrohet me të ri.

Me kërkesën për lëshim të orarit të ri të udhëtimit, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, transportuesi dorëzon dëshmi nga ku mund të verifikohet që i njëjti është i humbur, i vjetëruar ose i dëmtuar.

Neni 23

Orari i udhëtimit vendoset:

- në automjet,

-në fillim, dhe

-fund të qarkimit dhe në ndalesat.

Çdo transportues orarin vetanak të udhëtimit të regjistruar e vendos veçmas.

Neni 24

Hipja dhe zbritja e udhëtarëve bëhet vetëm në ndalesa, në përputhje me rendin e udhëtimit të aprovuar.

Neni 25

Transportuesi është i obliguar t'i mbajë linjat në përputhje me orarin e udhëtimit të regjistruar.

IV.Mënyra e organizimit të kontrollit të komunikacionit të automjeteve dhe linjave, dhe evidentimi i tyre

Neni 26

Kontrolli i komunikacionit të automjeteve dhe linjave në transportin e udhëtarëve në linja komunale në territorin e Komunës Dibër e kryen njësisia e inspektoratit e Komunës Dibër, përmes inspektorit të autorizuar për komunikacion rrugor ose me urdhër të Komunës mbikqyrjen e bën inspektori shtetëror për komunikacion rrugor në shpenzim të Komunës.

Transportin e udhëtarëve në linja komunale në territorin e Komunës Dibër mund ta kryejnë transportues që kanë fituar licencë për atë lloj transporti, të lëshuar nga kryetari i Komunës Dibër.

Licenca, leja dhe orari i udhëtimit në transportin e udhëtarëve në linja komunale lëshohet me afat vlefshmërie prej katër vitesh.

Neni 27

Gjatë kryerjes së transportit të udhëtarëve në linjat komunale në territorin e Komunës Dibër, transportuesi është i obliguar në automjet ta ketë licencën, lejen dhe orarin e udhëtimit të regjistruar në original.

Transportuesi është i obliguar t'i përmbahet orarit të udhëtimit të regjistruar dhe ta mbajë rregullisht linjën.

Neni 28

Automjetet në pjesën e përparme dhe anën e djathtë, në vend të dukshëm duhet të vendosin tabelën që përbën numrin e linjës, ndalesën fillestare dhe përfundimtare.

Neni 29

Spektori për urbanizëm, punë komunale, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe zhvillim ekonomik lokal i komunës Dibër, përmes Njesisë për punë komunale është i obliguar të bëjë evidencën e transportuesve dhe automjeteve të regjistruar për transport të udhëtarëve në linja komunale në territorin e Komunës Dibër.

Neni 30

Njesisë për punë komunale të Sektorit për urbanizëm, punë komunale, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe zhvillim ekonomik lokal i Komunës Dibër është e obliguar të mbledh, përpunojë, ruaj, ndërmjetëson dhe shfrytëzon të dhëna të nevojshme për lëshimin e licencave për kryerjen e transportit të udhëtarëve në linjat komunale në territorin e Komunës Dibër dhe regjistrim të orareve të udhëtimit të automjeteve, si dhe të të dhënave të nevojshme gjatë shpërndarjes së lejeve për transport të udhëtarëve.

Evidenca i përfshin të dhënat në vijim:

- numrin amë, numrin tatimor, emrin dhe selinë e transportuesit,
- emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për transport,
- numri dhe vlefshmëria e licencës, lloji i transportit për të cilin është dhënë licenca, lloji, tipi dhe numri i regjistrimit dhe të dhëna të tjera për automjetet për të cilat është dhënë licenca,
- emri dhe mbiemri, numri vetanak i amës (NVA) dhe arsimimi i shoferëve të punësuar,
- a është në fuqi aktvendimi i plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale kundër pronës, ekonomisë ose sigurisë në komunikacion,
- të dhëna për shlyerje të obligimeve në bazë të detyrimeve publike, dhe
- masa të shqiptuara kundër transportuesve në bazë të Ligjit për transport në komunikacionin rrugor.

Të dhënat nga paragrafi 2 i këtij neni mund të meren edhe prej Ministrisë për Punë të Brendshme, Ministrisë së Financave, gjykatës kompetente të shkallës së parë dhe Fondit për Sigurim Pensional Invalidor.

Njesisë për punë komunale nuk është e obliguar të njoftojë transportuesin se për cilat të dhëna bëhet fjalë.

Nr.3/03.06.2013 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 39

Organet, organizatat dhe personat që disponojnë me të dhënat, respektivisht përmbledhje të të dhënave nga paragrafi 2 i këtij neni, janë të obliguar sipas kërkesës paraprake këto të dhëna t'ia japin njësisë për punë komunale.

Neni 31

Të dhënat sipas nenit 30 të këtij vendimi evidentohen për gjithë kohën derisa transportuesi është në evidencën e transportuesvë në transportin e udhëtarëve në linja komunale në territorin e Komunës Dibër.

Të dhënat ruhen edhe pesë vjet nga dita kur transportuesi është çregjistruar nga evidence e transportuesve.

Të dhënat sipas nenit 30 të këtij vendimi mund t'iu jepen organeve të tjera shtetërore, nëse ata i kërkojnë dhe nëse kërkesa e tyre është e lidhur verësisht me veprimtarinë transportuese me të cilën merren transportuesit.

Neni 32

Njësia për punë komunale do ta çregjistrojë transportuesin nga evidence e transportuesve nëse:

- Transportuesit i ndalon vlefshmëria e licencës për kryerje të transportit të udhëtarëve në linja komunale, edhe atë, që nga dita e ndërprerjes së vlefshmërisë së licencës, dhe
- Transportuesi është fshirë nga rregjistri tregtar, edhe atë, nga dita e fshirjes.

V. Sistemi tarifor dhe sistemi i arkëtimit

Neni 33

Me sistemin tarifor përcaktohet çmimi i transportit në transportin e udhëtarëve në linja komunale në territorin e Komunës Dibër.

Sistemin tarifor e përcakton Këshilli i Komunës Dibër, me vendim të veçantë.

Neni 34

Sistemi i arkëtimit është arkëtimi i shërbimeve transportuese në transportin në linja komunale në territorin e Komunës Dibër.

Shërbimet transportuese arkëtohen përmes aparatit fiskal në automjet ose arkëtimi i shërbimeve transportuese mund të bëhet me bileta dhe bileta të parapaguara.

VI. Lokacioni i vendkthimeve, ndalesave dhe procedura e ndërrimit të tyre

Neni 35

Terminali i autobusëve është hapësirë e rregulluar e dedikuar për transferimin e udhëtarëve në transportin komunale të udhëtarëve dhe shërben për kthimin e automjeteve për shkak të ndërrimit të kahjes së lëvizjes.

Vendqarkimi i autobusit është hapësirë e rregulluar në pikat e fundit (termikus) në linjat e transportit komunal dedikuar për hipje dhe zbritje të udhëtarëve dhe shërben për kthimin e automjeteve për shkak të ndërrimit të kahjes së lëvizjes.

Ndalesa e autobusëve është hapësira e caktuar për ndalesë të autobusëve në pajtim me orarin e udhëtimit dhe për hyqjen e sigurt, gjegjësisht zbritjen e udhëtarëve.

Neni 36

Lokacionet e vendqarkimeve në transportin e udhëtarëve në linja komunale në territorin e Komunës Dibër janë:

- 1.Dibër (stacioni i autobusëve)
- 2.Dibër (degëzimi i rr.,,8-të Shtatori,, afër parkut
- 3.f.Banisht
- 4.f. Zepishtë
- 5.f.Mogorçë
- 6.f.Kosovrast i Poshtëm.

7.f.Kosovrast i Epërm.

Lokacionet për ndalesë të autobusëve në transportin e udhëtarëve në linja komunale në territorin e Komunës Dibër janë:

1.Dibër (degzimi i rr.,8-të Shtatori,, afër parkut

2.f.Banjisht

3.f.Xhepisht

4.f.Mogorç

5.f.Kosovrast i Poshtëm.

6.f.Kosovrast i Epërm.

Neni 37

Iniciativën për ngritje të procedurës për ndërrim të lokacioneve për vendqarkim dhe ndalesat mund të iniciojnë bashkësitë lokale, transportuesit dhe qytetarët deri te Këshilli i Komunës Dibër.

Këshilli i Komunës Dibër vendos për ndërrimin e lokacioneve për vendqarkimin dhe ndalesat e autobusëve.

VII. Ndërrtimi, shënimi, pajisja, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i ndalesave dhe vendkthimeve

Neni 38

Ndërtimin, shënimin, përcaktimin, mirëmbajtjen e terminaleve të autobusëve, vendqarkullimeve dhe ndalesave, në transportin e udhëtarëve në linjat komunale kryhet në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me Programin për ndërtim dhe rekonstrukcion, mirëmbajtje të rrugëve komunale të Komunës Dibër.

Për shfrytëzim të terminaleve të autobusëve, vendqarkullimeve dhe ndalesave, transportuesit paguajnë kompensim.

Lartësinë e kompensimit nga paragrafi 2 i këtij neni e përcakton Këshilli i Komunës.

VIII. Përcaktimi i relacionit dhe vendit për transport me automjet furgon, me min nëntë karrige (8+1)

Neni 39

Përcaktimi i relacioneve për transport me automjet furgon me më së paku nëntë karige (8+1) në transportin e udhëtarëve në linja komunale rregullohet me vendim të veçantë të aprovuar nga Këshilli Komunal.

IX. Kriteret për mënyrën dhe procedurën për dhënie dhe marrje të lejes për kryerje të transportit në linja komunale dhe shpërndarja e linjave për kryerje të transportit të udhëtarëve në linja komunale

Neni 40

Procedura për marrje dhe heqje të lejes për transport të rregullt të udhëtarëve në linja komunale, përfshin veprime të përcaktuara me të cilat personi i përcaktuar juridik ose fizik që posedon licencë për kryerje të transportit të udhëtarëve në linja komunale në territorin e Komunës Dibër fiton të drejtën të kryejë transport të udhëtarëve në linjën e përcaktuar, në pajtim me orarin e udhëtimit të përcaktuar dhe të verifikuar.

Neni 41

Kërkesën për marrje të lejes për transport të udhëtarëve në linja komunale nga ana e transportuesit, i cili ka orar të udhëtimit të aprovuar për linjë të përcaktuar, dorëzohet në Sektorin për urbanizëm, punë komunale, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe ZhEL-Njësia për punë komunale Dibër.

Nr.3/03.06.2013 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 41

Me kërkesën transportuesi dorëzon aktvendimin me të cilin i është aprovuar orari i udhëtimit për linjën për të cilën kërkohet leja dhe regjistrim i orarit të udhëtimit të lëshuara nga kryetari i Komunës Dibër.

Leja lëshohet në numër të nevojshëm egzemplarësh sa ka nisje të lejuara në orarin e udhëtimit. Me kërkesë të transportuesit mund të jepen më shumë egzemplarë.

Për dhënie të lejeve në transportin e udhëtarëve në linja komunale, veç aktvendimit dhe orarit të udhëtimit transportuesi dorëzon edhe çmimoren dhe itinerarin (përcaktimin e drejtimit të përcaktuar të lëvizjes të automjetit transportues në linjën e përcaktuar).

Neni 42

Leja për transport të udhëtarëve në linja komunale lëshohet në afat prej 30 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës për lëshim të saj.

Neni 43

Kërkesa për dhënie të lejes për transport të udhëtarëve në linja komunale do të refuzohet nëse kërkuesi:

- në afat prej 30 ditësh nga dita e aprovimit të orarit të udhëtimit nuk dorëzon kërkesë për dhënie të lejes,
- nuk dorëzon orar të udhëtimit të verifikuar dhe regjistruar,
- nuk ka licencë për kryerje të transportit të udhëtarëve në linja komunale,
- nuk ka numër të mjaftueshëm të automjeteve në pronësi,
- nuk ka më së paku nga një shofer të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune për automjetet.

Neni 44

Pas kalimit të afatit për të cilin është lëshuar, leja nga neni 41 i këtij vendimi mund të vazhdohet.

Kërkesa për vazhdim të vlefshmërisë së lejes dorëzohet në Sektorin për urbanizëm, punë komunale, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe ZhEL-Njësia për punë komunale Dibër, në afat prej 30 ditësh para skadimit të vlefshmërisë së lejes.

Me kërkesën për vazhdim të vlefshmërisë së lejes, transportuesi përveç dëshmive nga neni 41 i këtij vendimi dorëzon dhe kopje të lejes për të cilën kërkon vazhdim.

Neni 45

Leja nga neni 44 i këtij vendimi nuk do të vazhdohet, nëse:

- ka kaluar afati i vlefshmërisë së licencës,
- nuk i ka plotësuar obligimet sipas ligjit në lidhje me kryerjen e transportit (tatimin, sigurimin pensional invalidor),
- nuk ka numër adekuat të automjeteve në pronësi dhe së paku një shofer në marrëdhënie të rregullt pune sipas numrit të automjeteve,
- nëse në afat të vlefshmërisë së lejes ka kryer thyerje të rregullave për rregullsi teknike të automjeteve, kohës së drejtimit dhe pushimit të shoferëve.

Neni 46

Leja për kryerje të transportit të udhëtarëve në linja komunale transportuesit mund t'i merret, nëse:

- ka mbaruar vlefshmëria e licencës për kryerje të transportit të udhëtarëve në linja komunale,
- transportuesi nuk i plotëson kushtet sipas të cilave i është lëshuar leja, dhe
- me kërkesë të transportuesit.

Neni 47

Leja e humbur, e dëmtuar ose vjetruar mund të ndërrohet me të re me kërkesë të transportuesit.

Me kërkesën për lëshim të lejes së re, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, transportuesi dorëzon dëshmi nga ku mund të verifikohet që e njëjta është e humbur, dëmtuar ose e vjetruar.

X. Mbikëqyrja

Neni 48

Mbikëqyrjen për realizimin e dispozitave të këtij vendimi e kryen Sektori për urbanizëm, punë komunale, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe ZhEL-Njësia për punë komunale Dibër.

Neni 49

Mbikëqyrje inspektimi për zbatimin e dispozitave të këtij vendimi e kryen inspektori i autorizuar komunal për komunikacion rrugor i Komunës Dibër, ose me urdhëresë të Komunës mbikëqyrje do të bëjë inspektori republikan për komunikacion rrugor në shpenzim të komunës, të cilët marrin masa të parapara në pajtim me Ligjin për transport në komunikacionin rrugor.

Neni 50

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Kumtesën zyrtare të Komunës Dibër”.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 492/4 dt. 03.06.2013
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR CAKTIMIN E
ZONAVE PËR LLOGARITJEN E VLERËS SË TREGUT
TË PRONËS SË PATUNDSHME

31.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

SHPALLET vendimi për caktimin e zonave për llogaritjen e vlerës së tregut të pronës së patundshme, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e tretë dt.29.05.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M

Nr.07-453/7 dt. 29.05.2013

**PËR CAKTIMIN E ZONAVE PËR LLOGARITJEN E
VLERËS SË TREGUT TË PRONËS SË PATUNDSHME**

32.Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për vetqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 5/02), nenit 5 të Ligjit për tatimet në proneë (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 61/04), si dhe nenit 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 3^{të} dt. 29.05.2013 vendosi:

Neni 1

Për llogaritjen e vlerës së tregut të pronës së patundshme, në vartësi të favoreve që jep patundshmëria, sidomos në pikëpamje të pozitës, lidhjes së trafikut, paisja me objekte komunale dhe instalime, formohen 6 (gjashtë) zona.

Zonat nga paragrafi 1i këtij neni i kanë kufijtë në vijim:

EKSTRA ZONA Në këtë zonë hyjnë të gjitha ndërtesat e banimit dhe banesat, ndërtesat dhe hapsirat afariste, ndërtesat dhe hapsirat administrative dhe objektet tjera ndërtimore si dhe toka ndërtimore në :

- 1.Ana e majtë dhe e djathtë e **rr.,Bashkim Vëllazërim,,** (nga kryqëzimi me rr.,8-të Shtatori,, deri te bashkimi me rr.,22-Dhjetori,,),
- 2.Objekti afarist **„Tregu i qytetit,,**
- 3.Ana e majtë dhe e djathtë e **rr., 8-të Shtatori,,** (nga kryqzimi me qarkullim rreth deri te kryqzimi me rr.,Bashkim Vëllazërim,,),
- 4.Ana e majtë dhe e djathtë e **rr.,Velko Vllahoviq,,** (nga kryqzimi me rr.,Bashkim Vëllazërim,, deri te kryqzimi me rr.,Bulevard Shkupi,,),
- 5.Ana e majtë dhe e djathtë e **rr.,Atanas Iliq,,** (nga bashkimi me rr.,Velko Vllahoviq,, deri te kryqzimi me rr.,Drini i Zi,,),

ZONA E I Në këtë zonë hyjnë të gjitha ndërtesat e banimit, banesat, ndërtesat dhe hapsirat afariste, ndërtesat dhe hapsirat administrative dhe objektet tjera ndërtimore si dhe toka ndërtimore në:

- 1.Përkap territorin mes (rr.,8-të Shtatori,, rr.,Velko Vllahoviq,, dhe „Bulevard 100,,),
- 2.Përkap territorin mes (rr.,Atanas Iliq,, rr.,Drini i Zi,, terrenet sportive „Bulevard Shkupi,, dhe rr.,Velko Vllahoviq,,)
- 3.Ana e majtë dhe e djathtë e rr.,Atanas Iliq,, (nga kryqzimi me rr.,Drini i Zi,, deri te kryqzimi me rr.,Amdi Lleshi,,),
- 4.Përkap territorin mes (rr.,Bashkim Vëllazërim,, rr.,Drini i Zi,, rr.,Atanas Iliq,, dhe rr.,Velko Vllahoviq,,),
- 5.Përkap territorin mes (rr.,Bashkim Vllazrim,, rr.,Drini i Zi,, rr.,Jordan Zafirovski,, dhe rr.,Angjele Oboçki,,),
- 6.Përkap teritorin mes (rr.,Jordan Zafirovski,, rr.,Amdi Lleshi,, dhe rr.,Bashkim Vëllazërim,,),
- 7.Ana e majtë dhe e djathtë e **rr.,22-Dhjetori,,** (nga kryqzimi me rr.,Ibrahim Kolari,, deri te kryqzimi me rr.,Amdi Lleshi,,),
- 8.Ana e majtë dhe e djathtë e **rr.,Amdi Lleshi,,** (nga kryqzimi me rr.,22-Dhjetori,, deri te kryqzimi me rr.,Atanas Iliq,,),
- 9.Ana e majtë dhe e djathtë e **rr.,Beton,,** (nga kryqzimi me rr.,Atanas Iliq,, deri te kryqzimi me rr.,Velko Vllahoviq,,),
- 10.Ana e majtë dhe e djathtë e **rr.,Velko Vllahoviq,,** (nga kryqzimi me qarkullim rreth deri te kryqzimi me rr.,200,,),
- 11.Përkap territorin mes („Bulevardit 100,, krahu i „Bulevardit 100,, rr.,Urfi Agolli,, dhe rr.,8-të Shtatori,,),

12. Përkap territorin të SHA „KNAUF,,
 - 13 Përkap territorin mes (rr.,,1-Maji,, rr.,,8-Shtatori,, rr.,,APJ,,),
 - 14.Përkap territorin mes (rr.,,1-Maji,, rr.,,APJ,, rr.,,Bashkim Vllazrim,, rr.,,Ibe Palikuqi,, rr.,,Ejup Qatipi,, rr.,,Petre Popovski,, dh err.,,22-Dhjetori,,),
 - 15.Ana e majtë dhe e djathtë e **rr.,,1-Maji,,** (nga kryqzimi me qarkullim rreth deri te kryqzimi me rr.,,APJ,,),
 - 16.Ana e majtë dhe e djathtë e **rr.,,8-të Shtatori,,** (nga uranë hyrje të qytetit deri te kryqzimi me qarkullim rrethor).
- Lartësia e pikëve të tokës ndërtimore në këtë zonë për m² do të lëvizë prej 15-18 pikë.

ZONA E II Në këtë zonë hyjnë të gjitha ndërtesat e banimit, banesat, ndërtesat dhe hapsirat afariste, ndërtesat dhe hapsirat administrative dhe objektet tjera ndërtimore si dhe toka ndërtimore në:

- 1.Ana e majtë dhe e djathtë e rr.,,22-Dhjetori,, (nga kryqzimi me rr.,,Shkupit,, deri te dalja nga qyteti),
- 2.Përkap territorin mes (rr.,,22-Dhjetori,, rr.,,Edvard Kardel,, rr.,,Ice Risteski,, dhe rr.,,Shkupit,,),
- 3.Ana e djathtë dhe e majtë e rr.,,Ice Risteski,,
- 4.Përkap territorin mes (rr.,,Edvard Kardel,, rr.,,8-Marsi,, rr.,,Edip Papraniku,, rr.,,Atanas Iliq,, dhe rr.,,Amdi Lleshi,,),
- 5.Përkap territorin mes (rr.,,Jordan Zafirovski,, rr.,,29-Nëntori,, rr.,,Drini i Zi,, rr.,,Atanas Iliq,, rr.,,Amdi Lleshi,,),
- 6.Përkap territorin mes (rr.,,Atanas Iliq,, rr.,,Drini i Zi,, terrenet sportive rr.,,Bulevard Shkupi,, dhe rr.,,Beton,,),
- 7.Përkap territorin mes (rr.,,Atanas Iliq,, rr.,,Partizanska,, rr.,,200,, rr.,,Velko Vllahoviq,, dhe rr.,,Beton,,),
- 8.Përkap territorin mes (rr.,,Velko Vllahoviq,, rr.,,200,, „Bulevard 100,, krahu i rr.,,Bulevard 100,,),
- 9.Ana e majtë dhe e djathtë e rr.,,Velko Vllahoviq,, (nga kryqzimi me rr.,,200,, deri te dalja nga qyteti),
- 10.Përkap territorin mes (rr.,,8-Shtatori,, rr.,,Urfi Agolli,, krahu i „Bulevard 100,, dhe rruga qarkore),
- 11.Ana e majtë dhe e djathtë e rr.,,Zhivko Bogdanovski,, (nga kryqzimi me rr.,,1-Maji deri te dalja nga qyteti),
- 12.Përkap territorin mes (rr.,,Zhivko Bogdanovski,, rr.,,1-Maji,, SHA „KNAUF,,
- 13.Përkap territorin mes (rr.,,1-Maji,, rr.,,Ibe Palikuqi,, dhe rr.,,Ejup Qatipi,,),
- 14.Përkap territorin mes (rr.,,Petre Popovski,, rr.,,Dilaver Sela,, dhe rr.,,Ibrahim Kolari,,)

ZONA E III Në këtë zonë hyjnë të gjitha ndërtesat e banimit, banesat, ndërtesat dhe hapsirat afariste, ndërtesat dhe hapsirat administrative dhe objektet tjera ndërtimore si dhe toka ndërtimore në:

- 1.Përkap territorin mes (rr.,,Ice Risteski,, rr.,,8-Marsi,, rr.,,Edip Papraniku,, rr.,,Zeqir Çanka,, rr.,,Partizanska,, rr.,,200,, rr.,,Velko Vllahoviq,, qarkorja rr.,,Korpusi 15,, me kufirin urbanistik të qytetit),
- 2.Përkap teritorin mes (krahu i „Bulevard 100,, rr.,,200,, rr.,,Velko Vllahoviq,, dhe me kufirin urbanistik të qytetit),
- 3.Përkap territorin mes (rr.Shkupit,, rr.,,Ice Risteski,, dhe rr.,,22-Dhjetori,,),
- 4.Përkap territorin mes (rr.,,22-Dhjetori,, rr.,,Ibrahim Kolari,, rr.,,Dilaver Sela,, rr.,,Petre Popovski,, rr.,,Ibe Palikuqi,, rr.,,APJ,, rr.,,Pavle Xhikovski,, dhe me kufirin urbanistik të qytetit),
- 5.Ana e majtë dhe e djathtë e Lagjes Rajçicë,
- 6.Përkap teritorin te Vendi i quajtur „VOJKË,,

ZONA E IV Në këtë zonë hyjnë të gjitha ndërtesat e banimit, banesat, ndërtesat dhe hapsirat afariste, ndërtesat dhe hapsirat administrative dhe objektet tjera ndërtimore si dhe toka ndërtimore në:

Nr.3/03.06.2013 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 46

Pjesa e sipërme të qytetit, lagjet „Konjarë,, „Taranik,, dhe „Rajçicë,, fshatrat Banjisht dhe Kosovrast i Poshtëm (pjesa e re).

ZONA E V Në këtë zonë hyjnë të gjitha ndërtesat e banimit, banesat, ndërtesat dhe hapsirat afariste, ndërtesat dhe hapsirat administrative dhe objektet tjera ndërtimore si dhe toka ndërtimore në:

Fshatrat: Zepishte, Otishan, Rajçicë, Kosovrast i Poshtëm, Kosovrast i Epërm, Tatar Elevcë, Gari, Osoj, Mogorçë, Bomove, Taranik, Sushicë, Konjarë, Spas, Krivcë, Hame, Sollokiq dhe Shullan.

Për gjithë zonat e përshkuara pjesë përbërëse është pjesa grafike, respektivisht harta e qytetit Dibër në përpjesë 1:5000.

Neni 2

Në bazë të nenit 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11) gjatë përcaktimit të vlerës së tregut të pronës së patundshme zonat e komunës Dibër vlersohen si më poshtë:

Ekstra zonë i përgjigjet zonës së tetë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11), gjatë llogaritjes për gjithë objektet me përjashtim të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Ekstra zona i përgjigjet zonës së pesëmbëdhjetë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11) gjatë përcaktimit e vlerës së tregut të pronës së patundshme të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Zona I i përgjigjet zonës së nëntë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11), gjatë llogaritjes për gjithë objektet me përjashtim të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Zona I i përgjigjet zonës së gjashtëmbëdhjetë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11) gjatë përcaktimit e vlerës së tregut të pronës së patundshme gjat llogaritjes të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Zona II i përgjigjet zonës së dhjetë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11), gjatë llogaritjes për gjithë objektet me përjashtim të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Zona II i përgjigjet zonës së gjashtëmbëdhjetë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11) gjatë përcaktimit e vlerës së tregut të pronës së patundshme gjatë llogaritjes të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Zona III i përgjigjet zonës së njëmbëdhjetë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11), gjatë llogaritjes për gjithë objektet me përjashtim të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Zona III i përgjigjet zonës së gjashtëmbëdhjetë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11) gjatë përcaktimit e vlerës së tregut të pronës së patundshme gjatë llogaritjes të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Zona IV i përgjigjet zonës së njëmbëdhjetë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11), gjatë llogaritjes për gjithë objektet me përjashtim të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Nr.3/03.06.2013 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq. 47

Zona IV i përgjigjet zonës së shtatëmbëdhjetë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11) gjatë përcaktimit e vlerës së tregut të pronës së patundshme gjat llogaritjes të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Zona V i përgjigjet zonës së trembëdhjetë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM”nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11), gjatë llogaritjes për gjith ëobjektet me përjashtim të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Zona V i përgjigjet zonës së tetëmbëdhjetë e përcaktuar në nenin 16 të Metodologjisë për përcaktimin e vlerës së tregut të pronës së patundshme (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 50/05, 40/10, 46/10 dhe 183/11) gjatë përcaktimit e vlerës së tregut të pronës së patundshme gjat llogaritjes të objekteve ndihmëse dhe tokës së pandërtuar ndërtimore.

Neni i 3

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejë vendimi për përcaktimin e zonave dhe bodave sipas zonave për llogaritjen e vlerës së tregut të pronës së patundshme për përcaktimin e tatimit në qarkullim të patundshmërive në teritorin e Komunës Dibër („Kumtesa zyrtare e Komunës Dibër,, nr.5/2009).

Neni i 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e tetë nga shpallja në „Kumtesën zyrtare të Komunës Dibër,,

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetar,
Bashkim Mashkulli d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.08- 492/5 dt. 03.06.2013
PËR SHPALLJE TË VENDIMIT
PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENSIMIT
TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË KOMUNËS DIBËR

33.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

SHPALLET vendimi për përcaktimin e kompensimit të këshilltarëve të Këshillit të Komunës Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e tretë dt.29.05.2013.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

VENDIM

Nr. 07-453/8 dt. 29.05.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENSIMIT TË
ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË KOMUNËS DIBËR**

34.Në mbështetje të dispozitave të Ligjit për plotësim të Ligjit për rroga dhe kompensime tjera të deputetëve në Kuvendin e RM-së dhe personave tjerë të zgjedhur dhe emëruar në Republikë („Gazeta Zyrtare e RM,, nr.121/07,161,07,161,08,92/09, 42/10), nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale („Gazeta Zyrtare e RM,, nr.5/02) si dhe nenit 59 të Statutit të komunës („Kumtesa Zyrtare e Komunës,, nr 14/03) me propozim të komisionit për çëshjtje mandatore,zgjedhje dhe emërimë,

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 3^{te} datë 29.05.2013 vendosi:

Neni 1

Anëtarëve të Këshillit të Komunës u takon kompensim mujor për pjesëmarrje në seancat e Këshillit dhe kompensim të shpënzimeve ditore dhe të rrugës.

Mjetet për pagesë të kompensimeve nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohen në Buxhetin e komunës Dibër.

Neni 2

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në seancat e Këshillit përcaktohet në lartësinë 50% të rrogës mesatare mujore neto në Republikë, paguar në vitin e kaluar.

Neni 3

Kryetarit të këshillit të komunës për udhëheqje dhe organizim të punës së Këshillit kompensimi nga neni 2 i rritet për 30%

Neni 4

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në seancat e Këshillit, paguhet për pjesëmarrje në të gjitha seancat e Këshillit mbajtur gjatë muajit në vijim.

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në seancat e Këshillit, zvogëlohet për 30%, për ç’do mungesë nga seanca e Këshillit.

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në seancat e Këshillit nuk paguhet, nëse anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në asnjë seancë të Këshillit.

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në seancat e Këshillit nuk paguhet, nëse Këshilli në muajin vijues nuk ka mbajtur asnjë seancë.

Neni 5

Pjesëmarrja në seancat e Këshillit konstatohet me plotësimin dhe nënshkrimin e fletëparaqitjes për pjesëmarrje, e cila obligativisht jepet në fund të seancës të Këshillit. Në rast të lëshimit më herët të seancës fletëparaqitje për pjesëmarrje plotësohet me lejen paraprake të kryetarit të Këshillit.

Neni 6

Anëtarëve të Këshillit u paguhet kompensim për shpenzimet rrugore dhe ditore gjatë udhëtimeve zyrtare në vend dhe jashtë, në pajtim me dispozitat që kanë të bëjnë me nëpunësit shtetëror në administratën komunale të Komunës Dibër.

Anëtarëve të jashtëm të komisioneve të Këshillit për pjesëmarrje dhe punë në të njejtat u paguhet kompensim në shumën 500,00 den, për mbledhje.

Anëtarëve të Këshillit dhe komisioneve të Këshillit, të cilët jetojnë jashtë qytetit për pjesëmarrje në seancat pas orarit të punës u paguhen shpenzimet rrugore në lartësinë e biletës së paguar deri në vendin ku jeton, gjegjësisht deri në shumën 200,00 den.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlejë vendimi i mëparshëm për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Këshillit të Komunës Dibër 07-1169/9 dt. 26.12.2007.

Neni 9

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga shpallja në “Kumtesën Zyrtare të Komunës”

KËSHILLI I KOM UNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v.

AKTE TË KRYETARIT TË KOMUNËS

A K T V E N D I M
Nr. 08-397/1 dt. 7.05.2013
PËR CAKTIMIN E ANËTARIT TË
KËSHILLIT TË KOMUNËS QË DO TË ZËVËNDËSOJË
KRYETARIN E KOMUNËS NË RAST
PENGESE APO MUNGESË

Në mbështetje të nenit 50, 52 paragrafi 5,6 dhe nenit 63 të Ligjit për vetqeversije lokale (“Gazeta zyrtare e RM”nr.5’2002) si dhe nenit 49 të Statutit të Komunës (“Kumtesa zyrtare e Komunës” nr.14/03),

Kryetari i komunës vendosi:

1. ULUMBIJE CAMI anëtare i Këshillit të Komunës Dibër përcaktohet që të zëvendësojë Kryetarin e Komunës për kryerjen e këtij funksioni në rast pengese apo mungese të tij.
2. Këshilltares ULUMBIJE CAMI gjatë kohës së zëvendësimit të Kryetarit të Komunës i pushon funksioni anëtare e Këshillit të Komunës.
3. Aktvendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kryetari
Ruzhdi Lata

DORËZUAR :

Ulumbije Cami _____

Kryetari i Këshillit _____

Arkiva _____

Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, nr.5/02) në lidhje me nenin 129 paragrafi 2 të Ligjit për ndërtim („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, nr. 130/2009, 124/10, 18/11, 36/ 11, 54/11, 13/12 и 144/12),),

Kryetari i komunës sjell:

RREGULLORE
PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARIT TË LIBRESËS SË
INSPEKTORIT TË AUTORIZUAR TË NDËRTIMIT DHE MËNYRËN E
DHËNIES DHE MARRJES SË SAJ

Neni 1

Me këtë rregullore përshkruhet forma dhe përmbajtja e formularit të libresës dhe emblemës së inspektorit të autorizuar të ndërtimit dhe mënyra e dhënies dhe marrjes së saj.

Neni 2

Libresa e inspektorit të autorizuar të ndërtimit lëshohet në formularin që është dhënë si Shtojcë dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Formulari i libresës nga paragrafi 1 i këtij neni është në formë të drejkëndëshit e punuar nga letra e bardhë hamer me dimensione 15 x11 cm, e pas palosje merr dimensione 7.5 x 11 cm e mbëshjtellur me copë lëkure të përpunuar me ngjyrë të verdhë (kopertina e libresës).

Në faqen e parë të kopertinës së libresës në pjesën e sipërme me ngjyrë ari të kuqe është e shtypur stema e Republikës së Maqedonisë, me dimensione 1cm x 1cm, nën te i shtypur me ngjyrë të verdhë ari teksti: REPUBLIKA E MAQEDONISË, KOMUNA DIBËR ndërsa në mes të kopertinës teksti me ngjyrë të kuqe: **LIBRESË E INSPEKTORIT TË AUTORIZUAR TË NDËRTIMIT** në gjuhën maqedonishte dhe gjuhën shqipe.

Nën këtë tekst është e shtypur emblema e inspektorit të autorizuar të ndërtimit.Emblena është me ngjyrë të verdhë në formë të trekëndëshit me dimensione 4.5 x 4.5 x 4.5 cm me cepa ngjyrë të zezë prej 2 mm.

Në brendësi në anën e majtë të formularit është e shtypur stema e Komunës e nën te teksti : KOMUNA DIBËR” dhe ndër këtë tekst në anën e majtë është vëndi i fotografisë me madhësi 2.5 x 3.5 cm. Në pjesën e poshtme është vëndi për të dhënat: emri dhe mbiemri i inspektorit të autorizuar të ndërtimit, nënshkrimi, numri i libresës, data e lëshimit, nënshkrimi i Kryetarit të Komunës dhe vëndi për vulë (V.V) në gjuhën maqedonishte dhe gjuhën shqipe.

Në anën e djathtë të brendësisë të formularit është i shtypur teksti: Inspektori i autorizuar i ndërtimit bën mbikqyrje inspektimi lidhur me zbatimin e Ligjit për ndërtim dhe dispozitat e miratuara mbi bazën e këtij ligji për ndërtimet e kategorisë së tretë, katërtë dhe pestë sipas kompetencave të përcaktuara me Ligjin për ndërtim, në gjuhën maqedonishte dhe gjuhën shqipe

Pjesëmarësit në ndërtim janë të obliguar që inspektorit të autorizuar të ndërtimit t'i mundësojnë mbikqyrje inspektimi pa pengesa dhe ti japin në shikim dokumentacionin e ndërtimit që është lëndë e inspektimit.

Neni 3

Libresën e inspektorit të autorizuar të ndërtimit e lëshon Kryetari i Komunës.

Për libresat e lëshuara dhe të marra të inspektorit të autorizuar të ndërtimit mbahet evidencë.

Numri rëndor me të cilin është bërë rregjistrimi shënohet si numër rregjistruar i libresës së inspektorit të autorizuar të ndërtimit.

Neni 4

Libresa është e vlefshme deri sa personi të cilit i është dhënë ajo, ka statusin e personit zyrtar.

Nëse inspektorit të autorizuar të ndërtimit i pushon marrëdhënia e punës në komunës ose nëse sistemohet në vënd tjetër pune, libresën ia kthen Kryetarit të Komunës.

Në rast të humbjes së libresës, inspektori i autorizuar i ndërtimit menjëherë e më së voni mbrenda afatit 3 ditor duhet të informojë Kryetarin e Komunës, i cili, pasi të shpall pavleshmërinë e libresës, inspektorit të autorizuar të ndërtimit i lëshon libresë të re.

Libresa zëvendësohet me të re kur për shkak të dëmtimit ose vjetërsisë bëhet e papërdorëshme si dhe në rast të ndërtimit të të dhënave personale të inspektorit të autorizuar të ndërtimit.

Libresa e cila kthehet ose zëvendësohet azgjesohet.

Neni 5

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në „Kumtesën zyrtare të Komunës,,.

Nr.08-446/1
22.05.2013
D i b ë r

Kryetari,
Ruzhdi Lata

P Ë R B A J T J A

25	Konkluzion për shpallje të përfundimit për sjelljen e Programit për plotësim të Programit vjetor për përpunimin e Planeve urbanistike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2013	_____	27
26	Përfundim për sjelljen e Programit për plotësim të Programit vjetor për përpunimin e Planeve urbanistike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2013	_____	28
-	Program për plotësim të Programit vjetor për përpunimin e Planeve urbanistike në territorin e Komunës Dibër për vitin 2013	_____	29
27	Konkluzion për shpallje të vendimit për sjelljen e Planit Detal Urbanistik për pjesën qendrore të qytetit, pjesë e bllokut 1 dhe 2 Dibër	_____	30
28	Vendim për sjelljen e Planit Detal Urbanistik për pjesën qendrore të qytetit, pjesë e bllokut 1 dhe 2 Dibër	_____	31
29	Konkluzion për shpallje vendimit për transport të udhëtarëve në linjë komunale në territorin e Komunës Dibër	_____	32
30	Vendim për transport të udhëtarëve në linjë komunale në territorin e Komunës Dibër	_____	33
31	Konkluzion për shpallje të vendimit për caktimin e zonave për llogaritjen e vlrës së tregut të pronës së patundshme	_____	43
32	Vendim për caktimin e zonave për llogaritjen e vlrës së tregut të pronës së patundshme	_____	44
33	Konkluzion për shpallje të vendimit për përcaktimin e kompensimit të këshilltarëve të Këshillit të Komunës Dibër	_____	48
34	Vendim për përcaktimin e kompensimit të këshilltarëve të Këshillit të Komunës Dibër	_____	49
	AKTE TË KRYETARIT TË KOMUNËS	_____	50
-	Për caktimin e anëtarit të Këshillit të komunës që do të zëvendësojë Kryetarin e komunës në rast Pengese apo mungese	_____	51
-	Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularit të libesës së inspektorit të autorizuar të ndërtimit dhe mënyrën e dhënies dhe marrjes së saj	_____	52

